

KOMISIONI I DISIPLINËS VENDIM Nr. 2

Nr. 14 Prot.

11 Shkurt 2025

Më datë **11 shkurt 2025**, u mbledh **Komisioni i Disiplinës** i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, **z. Klevis Kaso**, me praninë e anëtarëve, **z. Franko Bushati** dhe **z. Klaudio Ndoja**, për shqyrtimin e çështjes së tërheqjes nga Kupa e Shqipërisë Meshkuj e ekipit "Teuta", datë 6 shkurt 2025, ndeshja ¼ Finale Teuta vs Elbasani.

Pas shqyrtimit të materialeve përkatëse dhe në bazë të **nenit 4.5 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, si dhe duke marrë në konsideratë komunikimet ndërmjet përfaqësuesve të FSHB-së dhe shoqatës "Teuta Basket", **Komisioni i Disiplinës** vendosi:

1. **Sanksion financiar 30'000 lek për shoqatën "Teuta Basket"** në bazë të nenit 4.5 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit.

"Ekipet që nuk marrin pjesë në Kupën e Shqipërisë ose tërhiqen gjatë aktivitetit, gjobiten me 30'000 lek"

2. **Tërheqje vëmendjeje për shoqatën "Teuta Basket"**

Komisioni i Disiplinës i tërheq vëmendjen shoqatës "Teuta Basket", duke kërkuar respektimin e **etikës profesionale** në deklaratat publike që mund të dëmtojnë **integritetin e FSHB-së**. Në rast të përsëritjes së **deklaratave fyese**, do të aplikohet **masa disiplinore sipas nenit 14.10 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, që parashikon:

"Deklaratat fyese të personave drejtues të shoqatave, trajnerëve, lojtarëve apo personave të tjerë që qëndrojnë në stol, të cilat dëmtojnë imazhin e FSHB-së, të bëra publikisht në media apo rrjete sociale - 100,000 lekë gjobë."

E Drejta për Ankimim

Sipas **nenit 11.8 të Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit**, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim brenda **72 orëve** nga marrja e vendimit. Ankimi duhet të dorëzohet pranë **Komisionit të Apelit të FSHB-së** dhe të shoqërohet me vërtetimin e pagesës prej **10,000 lekësh** në arkën e FSHB-së.

Një kopje e kërkesës së ankimit i dërgohet palëve të përfshira. **Komisioni i Apelit** shqyrton çdo vendim të **Komisionit të Disiplinës** që kontestohet nga palët e interesuara.

Vendimet e **Komisionit të Apelit** mund të ankimohen pranë **Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS)**.



Klevis Kaso
Kryetar



Franko Bushati
Anëtar



Klaudio Ndoja
Anëtar